



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:016564
Datë: 16.08.2024
Numri i dokumentit: 06057712

CAP.nr.1277/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtarja individuale Frosina Sylejmani, me bashkëpunëtorin profesional Kastriot Makolli, në çështjen juridike – përmbartimore të kreditorit Komuna e Prishtinës, kundër debitorit F.A nga Ferizaj, me objekt të përmbartimit kërkesë në të holla – pagesa e gjobës mandatore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.22/22 i datës 06.07.2023, me datë 16.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e kreditorit Komuna e Prishtinës, ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.22/22 i datës 06.07.2023, dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin PPP.nr.22/22 të datës 06.07.2023, ka aprovuar të bazuar prapësimin e debitorit F.A të ushtruar kundër urdhrin për përmbartim P.nr.18/22, të datës 13.01.2022, i lëshuar nga Përmbartuesi privat Valdrin Beka nga Prishtina dhe ka shfuqizuar në tërësi urdhrin për përmbartim P.nr.18/22, i datës 13.01.2022, si dhe ka anuluar në tërësi veprimet e kryera përmbartimore sipas urdhrin P.nr.18/22, të datës 13.01.2022.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori Komuna e Prishtinës, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa ndërsa aktvendimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që të refuzohet prapësimi i debitorit.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar debitori me propozim që të refuzohet si e pabazuar aneksa e kreditorit ndërsa aktvendimi i ankimuar PPP.nr.22/22 i datës 06.07.2023 të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), ka gjetur se:

Ankesa e kreditorit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbartuesi Privat Valdrin Beka, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të dorëzuar nga kreditori Komuna e Prishtinës, me urdhrin P.nr.18/22, të datës 13.01.2022 e ka caktuar përmbartimin ndaj debitorit F.A, për pagesën e gjobës prej 300 euro, me kamatë prej 8% në vit, dhe shpenzimet e procedurës, në bazë të urdhërësës për pagesë të ndëshkimit me gjobë mandatore me numër ///, e datës ///, ose ndalimin e mjeteve në para të cilat i ka debitori në llogaritë bankare në të gjitha bankat komerciale.

Kundër këtij urdhri mbi lejimin e përmbartimit, brenda afatit ligjor, debitori ka paraqitur prapësim, ku mes tjerash ka theksuar se dokumenti në bazë të së cilit është nxjerr urdhri përmbartues nuk ka titull ekzekutiv dhe i mungojnë tiparet e përmbartueshmërisë, për faktin se gjoba për të cilën kreditori ka propozuar të përmbartohet nuk përbën një dokument përmbartues sipas paragrafit 1.2, neni 22 i Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, me të cilin janë specifikuar se cilat janë dokumentet përmbartuese, kjo për shkak se autoriteti nuk ka respektuar procedurën administrative të dorëzimit të aktit. Andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovohet i bazuar prapësimi dhe të shfuqizohet urdhri përmbartimor P.nr.15/22 i datës 13.01.2022.

Kreditori ka ushtruar përgjigje me shkrim në prapësimin e debitorit, me të cilën i ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar, për faktin se dokumenti përmbartues i nxjerr në procedurën administrative/kundërvajtëse është në përputhje me nenin 24.4 të LPP-së dhe është bërë i përmbartueshëm sipas rregullave që rregullohet kjo procedurë, konkretisht sipas nenit 30.4 të Ligjit për Kundërvajtje.

Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, me aktvendimin PPP.nr.22/22 i datës 06.07.2023 ka vendosur që ta aprovoj si të bazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se urdhri për përmbartim P.nr.18/22, i datës 13.01.2022, i lëshuar nga Përmbartuesi Privat Valdrin Beka, është marrë me shkelje të dispozitave të nenit 22, par 1, nën par 1.2 dhe neni 36, par 1, të LPP-së. Sa i përket pretendimit të debitorit në prapësim se dokumenti në bazë të cilit është nxjerrë urdhri përmbartues nuk ka titull ekzekutiv dhe nuk ka tiparet e përmbartueshmërisë dhe drejtoria e Inspeksionit të kreditorit ka lëshuar urdhërësën për pagesë për ndëshkimin me gjobë mandatore. Ky dokument nuk përmban elementet e duhura të një dokumenti të përmbartueshëm. Gjoba për të cilën kreditori ka propozuar dhe përmbartuesi privat e ka lejuar përmbartimin nuk përbën një dokument përmbartues sipas nenit 22, të Ligjit për Procedurën Përmbartimore me të cilin janë specifikuar se cilat janë dokumente përmbartuese, gjykata këto pretendime i konsideron të

bazuara, sepse me rastin e shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se urdhri për përbarim P.nr.18/22, i datës 13.01.2022, i lëshuar nga Përbaruesi Privat Valdrin Beka, është marr me shkelje të dispozitave ligjore të nenit 22, par 1, nën par 1.2 dhe nenit 36, par 1, të LPP-së, për shkak se urdhëresa për ndëshkim me gjobë mandatorë, me numër /// e datës ///, nuk mund të konsiderohet dokument përbarimor nga se urdhëresa në fjalë siç shihet nuk e përmban klauzolën e përbarueshmërisë për përbarueshmëri, kusht ky i kërkuar nga neni 36, par 1, të LPP-së, në të cilin është paraparë shprehimisht se : “Së bashku me propozimin për përbarim, organit përbarues i dorëzohet edhe dokumenti përbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përbarueshmërisë për përbarueshmëri.

Gjykata e shkallës së parë për mënyrën e vendosjes vendimin e saj e ka mbështetur në dispozitat e nenit 22, 36, dhe 73 të LPP-së.

Gjykata e Apelit qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 182.1, 182.2 pika (n), 183 të LPK-së, e lidhur me nenin 22 paragrafi 1, pika 1.9 të LPP-së.

Aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, pasi që dispozitivi i aktvendimit është i pakuptueshëm, në kundërshtim me arsyet e aktvendimit e po ashtu arsyet e paraqitura lidhur me faktet vendimtare të çështjes janë të mangëta dhe të paqarta.

Gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, kur ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit, duke e shfuqizuar urdhrin përbarimor P.nr.15/22 i datës 13.01.2022.

Gjykata e Apelit vlerëson se me dispozitën e nenit 22 paragrafi 1, nën paragrafi 1.9 të LPP-së përcaktohet se: Dokumente përbaruese janë: “dokumenti tjetër që me ligj është quajtur dokument përbarues”. Ndërsa me dispozitën e nenit 30.1 të Ligjit për Kundërvajtje parashihet: “ Në vendimin për kundërvajtje, me të cilin përcaktohet afati i pagimit të gjobës, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se pesëmbëdhjetë (15) ditë, dhe më i gjatë se nëntëdhjetë (90) ditë nga data e formës së prerë të vendimit, ndërsa në rastet e arsyeshme, varësisht nga lartësia e dënimit me gjobë dhe gjendja ekonomike e të pandehurit, organi i kundërvajtjes apo gjykata mund të përcaktojë që sanksioni kundërvajtës, i shqiptuar me gjobë të paguhet në këste, por që afati i pagesës nuk mund të jetë më i gjatë se gjashtë (6) muaj” ndërsa me paragrafin 4 të të njëjtit nen përcaktohet: “Nëse kryesi pjesërisht ose në tërësi nuk e paguan gjobën në afatin e përcaktuar, do të zbatohet përbarimi i detyrueshëm në pajtim me dispozitat e Ligjit për Përbarim. Urdhri kundërvajtës përmes të cilit shqiptohet gjoba do të cilësohet dokument përbarues në përputhje me dispozitat e Ligjit për procedurën përbarimore”.

Në kuptim të këtyre dispozitave Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është jo i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që në rastin konkret përbarimi është lejuar në bazë të Gjobës ///, e datës ///, i cili paraqet dokument përbarues mbi bazën e të cilit mund të lejohet përbarimi në kuptim të dispozitave të lartë cituara. Në këtë kontekst Gjykata e Apelit vlerëson se nuk mund të pranohet një qëndrim dhe përfundim i tillë i gjykatës

së shkallës së parë, andaj edhe nga këto arsye është dashur që aktvendimi i atakuar të anulohet dhe çështja t'i kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të sërishëm.

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë duhet të ketë parasysh vërejtjet e cituara me lartë, të vlerësoj në mënyrë të drejtë shkaqet nga neni 71 të LPP-së, e në harmoni edhe me vërejtjet e lartcituara, e pas kësaj të vendosë në mënyrë meritore lidhur me prapësimin e debitorit, duke marr vendim të drejtë dhe të ligjshëm në përputhje të plotë me dispozitat ligjore në fuqi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së..

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.1277/2023 me datë 16.08.2024

Gjyqtarja
Frosina Sylejmani